



UNIVERSITETI I PRISHTINËS

Rr. Xhorxh Bush, Nr. 31, 10000 Prishtinë, Republika e Kosovës
Tel: +383 38 244 183 / 244 186 | E-mail: rektorati@uni-pr.edu
Ueb: www.uni-pr.edu

Nr. Prot: 1/751

Datë: 1 / 6 / 2026

Senati i Universitetit të Prishtinës, në kuadër të kompetencave të përcaktuara sipas nenit 20, në zbatim të neneve 148, 152, 153, 154 dhe 155 të Statutit të UP-së, në përputhje me Ligjin nr. 04/L-037 për Arsimin e Lartë në Republikën e Kosovës, si dhe Ligjin nr. 08/L-197 për Zyrtarët Publikë, Rregulloren nr. 1/282, dt. 03.06.2025, për procedurat përzgjedhëse lidhur me emërimin, avancimin dhe rizgjedhjen e personelit akademik, në mbledhjen e mbajtur më 29.04.2026, vendosi të

shpallë

K O N K U R S

për emërimin e personelit akademik në njësitë akademike të Universitetit të Prishtinës

I. FAKULTETI I MJEKËSISË

- Tre mësimdhënës për lëndët:** Anatomi patologjike (O, MP), Anatomi patologjike (O, ST), Patologji molekulare (Z, MP), Fiziologjia patologjike dhe anatomia patologjike (O, F), Histologjia dhe bazat e patologjisë (O, FZ), Bazat e patologjisë dhe patofiziologjisë (O, I), Aspektet patomorfologjike të sëmundjeve të sistemit lokomotor dhe nervor (Z, MA, F).
- Dy mësimdhënës për lëndët:** Biokimi mjekësore (O, MP), Biokimi klinike (O, MP), Biokimi e përgjithshme (F), Biokimi klinike (F), Biokimi e përgjithshme (O, S), Biokimi, Biofizikë, Radiologji (I), Biokimi gjenetike (Z), Biokimi (FZ).

3. **Një mësimpldhënës për lëndët:** Higjienë (O, MP), Epidemiologji, higjienë dhe mjekësi sociale (F), Nutricioni dhe dietetika (Z, MP), Epidemiologji, higjienë dhe mjekësi sociale (S).
4. **Një mësimpldhënës për lëndët:** Mjekësi interne - Hematologji (O, MP), Kujdesi infermieror te pacientët internistikë (O, I), Propedeutika e mjekësisë klinike (O, MP), Mjekësi interne (O, S), Hematologji - Praktikë klinike (MP).
5. **Një mësimpldhënës për lëndët:** Mjekësi interne - Pulmologji (O), Pulmologji - Praktikë klinike.
6. **Një mësimpldhënës për lëndët:** Oftalmologji (O, S), Oftalmologji (O, MP), Anomalitë e refrakcionit (Z) dhe Kujdesi ndaj personave të verbër (Z).
7. **Një mësimpldhënës për lëndët:** Sëmundjet infektive (O, MP), Sëmundjet infektive (O, S), Sindromat e organeve specifike në sëmundjet infektive (Z), Infeksionet te të imunokomprometuarit (Z).
8. **Dy asistentë për lëndët:** Anatomi patologjike (O, MP), Anatomi patologjike (O, S), Anatomi patologjike (O, FZ), Anatomi patologjike (I), Anatomi patologjike (F).
9. **Një asistent për lëndët:** Epidemiologji (O, MP), Shëndet publik (O, MP).
10. **Dy asistentë për lëndët:** Farmakologji (O, F), Bromatologji me toksikologji (O, F).
11. **Një asistent për lëndën:** Mikrobiologji (MP), Mikrobiologji (S), Mikrobiologji (F).
12. **Një asistent për lëndët:** Higjienë(MP), Epidemiologji, higjienë dhe mjekësi sociale (S).
13. **Dy asistentë për lëndët:** Farmakologji me toksikologji (MP, O), Farmakologji me toksikologji (S, O), Farmakologjia në infermieri (I, O).
14. **Një asistent për lëndën:** Kimi farmaceutike II.
15. **Dy asistent për lëndët:** Mjekësi sociale (MP), Statistikë mjekësore me informatikë (O, MP), Metodologji e punës shkencore (O, MP).
16. **Dy asistentë për lëndët:** Neurologji (MP), Psikiatri (MP), Neuropsikiatri (S), Neurologji dhe psikiatri – mësim klinik.
17. **Një asistent për lëndët:** Oftalmologji (O, S), Oftalmologji (O, MP).
18. **Dy asistentë për lëndët:** Pediatri (MP), Pediatri (S), Gjenetikë mjekësore, Pediatri - mësim klinik.
19. **Një asistent për lëndët:** Farmakognozi dhe barna komplementare (O, F), Bazat e farmacisë (O, F), Edukimi dhe Praktika interprofesionale (O, F).
20. **Një asistent për lëndët:** Protetika mobile klinike (O), Protetika klinike fikse (O), Protetikë-praktikë klinike (O).
21. **Një asistent për lëndët:** Radiologji (MP), Radiologji (S), Radiologji (FZ), Radiologji (I).
22. **Dy asistentë për lëndët:** Sëmundjet Infektive (O, MP), Sëmundjet infektive (O, S), Sëmundjet infektive - praktike klinike (MP, S).

23. **Një asistent për lëndët:** Praktika klinike II (I), Praktika klinike III (I), Kirurgji me kujdes infermieror (I).

II. FAKULTETI I SHKENCAVE MATEMATIKE-NATYRORE

1. **Një mësimdhënës për lëndët:** Biologji me gjenetikë (O, MP), Biologji molekulare (Z, MP), Citogjenetikë humane (Z, MP), Biologji me gjenetikë (O, S), Biologji me gjenetikë (O, F), Biologji molekulare (Z, S), Biologji molekulare (Z, F). (Për Fakultetin e Mjekësisë).

III. FAKULTETI I BUJQËSISË DHE VETERINARISË

1. **Një mësimdhënës për lëndët:** Fisnikërimi i pemëve dhe hardhisë së rrushit (Z, BSc, PB), Seleksionimi në hortikulturë dhe bimë frutore (O, MSc, PV), Prodhimtaria e veçantë e frutave (O, MSc, PV), Kultivimi organik i pemëve dhe hardhisë (O, MSc, PV), Biologjia dhe ekologjia e pemëve (Z, MSc, PV), Florikulturë (Zinxhiri i furnizimit me bimë) (Z, MSc, PV).
2. **Një mësimdhënës për lëndët:** Bioteknologjia ushqimore (O, BSc, TUB), Bazat e konservimit të ushqimeve (Z, BSc, TUB), Vetitë strukturore të ushqimeve (O, MSc, SHU), Metodot kuantitative (O, MSc, SHU), Inxhinieria në teknologjinë ushqimore (O, MSc, SHU), Siguria ushqimore (Z, BSc, TUB).
3. **Një asistent për lëndët:** Patologji 1 (O, MV), Patologji 2 (O, MV), Patologji 3 (O, MV), Patologji 4 (O, MV), Parazitologji 1 (O, MV), Parazitologji 2 (O, MV), Epidemiologji me sëmundje infektive 2 (O, MV).
4. **Një asistent për lëndët:** Kontrolli i prodhimeve ushqimore (O, Bsc, TUBT), Higjiena dhe teknologjia e qumështit dhe prodhimeve të tij (O, MV), Legjislacioni dhe menaxhimi i cilësisë (O, Bsc, TUBT), Teknologjia e qumështit dhe prodhimeve të tij (O, Bsc, TUBT), Teknikat e paketimit dhe ruajtjes së ushqimeve (O, Bsc, TUBT), Teknologjia e qumështit dhe prodhimeve të tij (Z, Msc, TUBT), Teknologjia e pasvjeljes (O, Msc, PV), Analiza sensorike e ushqimeve (O, Msc, SHU), Teknologjia e pasvjeljes (Z, Msc, PV), Ushqimet funksionale dhe nutraceutikët (O, Msc, SHU).

Kushtet e përgjithshme

Kushtet e përgjithshme për emërimin e personelit akademik në Universitetin e Prishtinës janë të përcaktuara në dispozitat përkatëse të [Statutit të UP-së](#), si dhe në [Rregulloren nr. 1/282, dt. 03.06.2025](#), për procedurat për zgjedhje lidhur me emërimin, avancimin dhe rizgjedhjen e personelit akademik në Universitetin e Prishtinës.

Dokumentet e nevojshme për aplikim

Kandidatët të cilët aplikojnë për pozitat në konkurs duhet t'i paraqesin këto dokumente:

1. Kërkesën për aplikim.
2. CV-në akademike, të plotë me të gjitha të arriturat, me DOI të publikimeve, me vegëza aktive dhe me dëshmi përkatëse (në formatin WORD dhe atë PDF).
3. Certifikatën e lindjes.
4. Diplomat (baçelor, master/magjistraturë dhe doktoratë, ose diplomën/at e programeve të integruara).
5. Vendimin/et për nostrifikim të diplomës/diplomave ose dëshminë e aplikimit për nostrifikim (vlen vetëm për kandidatët që i kanë mbaruar studimet jashtë vendit).
6. Certifikatat e notave të studimeve baçelor/integruara dhe master/magjistraturë (vlen vetëm për kandidatët që konkurrojnë për asistentë).
7. Dëshmitë për publikimet shkencore e profesionale brenda kornizës së përcaktuar me Statutin e UP-së dhe Rregulloret në fuqi për emërim, riemërim dhe avancim të personelit akademik (në formatin PDF).
8. Dëshmi për aftësi në mësimdhënie, duke paraqitur një portofolio të punës profesionale dhe një deklaratë të filozofisë së mësimdhënies për kandidatët që konkurrojnë për mësimdhënës (për kandidatët që konkurrojnë për asistentë mund të paraqiten si dëshmi shtesë).
9. Dëshmi të lëshuar nga Gjykata Themelore që nuk janë të dënuar.
10. Të gjitha informatat e tjera specifike shtesë, të cilat janë të rëndësishme.
11. Deklaratë me shkrim për gatishmëri të dorëheqjes nga vendi paraprak i punës në rast të zgjedhjes nga senati.

Dokumentet si në pikën 3, 4, 5 dhe 9 duhet të jenë në original ose kopje të vërtetuara nga noteri.

Dokumentet si në pikën 6 dhe 8 duhet të jenë në original ose kopje të vërtetuara nga noteri, ose të verifikueshme në institucionin që e ka lëshuar dokumentin.

Dispozita të përgjithshme dhe kufizime për menaxhimin e procesit të emërimeve

në UP

1. Të gjitha emërimet për tituj akademikë dhe kohëzgjatja e punësimit realizohen në përputhje me dispozitat përkatëse të Statutit të Universitetit të Prishtinës. Askush nuk mund të emërohet pa pasur vlerësim pozitiv nga Komisioni vlerësues, përkatësisht anëtarët e komisionit, bazuar në statut dhe rregullore.
2. Emërimi nuk është proces automatik; ai është konkurrues dhe bazohet në ligjshmëri dhe në meritokraci për të gjitha pozitat akademike.
3. Kandidatët që aplikojnë për themelimin e marrëdhënies së rregullt të punës për herë të parë në UP, të cilët janë të punësuar në një institucion publik ose privat (brenda ose jashtë vendit), si dhe në ndërmarrje ose persona juridikë të çfarëdo statusi, janë të detyruar që para nënshkrimit të kontratës së punës me UP-në, të sjellin dëshmi për dorëheqje të parevokueshme nga punëdhënësi paraprak. Nëse nuk e paraqesin këtë dëshmi, nuk mund të nënshkruajnë kontratë pune me Universitetin e Prishtinës.
4. Në mungesë të vendimit për nostrifikimin e diplomës në momentin e aplikimit për emërim, kandidati obligohet që jo më vonë se 3 ditë para mbledhjes së senatit ku shqyrtohet lënda, të dorëzojë vendimin për nostrifikim të diplomës/ave. Në të kundërtën, kandidatura do të refuzohet.
5. Shtetasit e huaj dhe personat pa shtetësi mund të themelojnë marrëdhënie pune në Republikën e Kosovës sipas kushteve dhe kriterëve të përcaktuara me ligjin e veçantë për punësimin e shtetasve të huaj dhe në përputhje me konventat ndërkombëtare.

Vendimi, periudha e ankimimit dhe përmbyllja e konkursit

1. Procedura e votimit në senat për propozimet e këshillit të fakultetit lidhur me emërimin e anëtarëve të personelit akademik bëhet sipas rregullores së punës së senatit.
2. Ndaj vendimit të senatit, në afat jo më larg se 15 ditë pas pranimit në dorëzim të vendimit, mund të bëhet ankesë në Komisionin e Senatit për Ankesa dhe Parashtresa, që shërben si instancë e fundit e ankimimit në UP.
3. Konkursi për emërimin e personelit akademik duhet të përmbyllet me vendime përkatëse të Senatit të UP-së për të gjitha vendet e shpallura, sipas afateve të përcaktuara në Rregulloret për procedurat përzgjedhëse lidhur me emërimin, avancimin dhe rizgjedhjen e personelit akademik në UP.
4. Për raste të veçanta para arritjes së propozimit në senat, me kërkesë të rektorit, afati i të gjithë procedurës mund të zgjatet edhe maksimumi 30 ditë.
5. Në rastet kur për shkaqe objektive nuk mund të organizohet mbledhja e organit kolegjial, afati i përmbylljes së procedurës së konkursit nuk rrjedh.

Mënyra e aplikimit

1. Aplikantët duhet të dorëzojnë të gjitha dokumentet e nevojshme online përmes vegës zyrtare (<https://stafiakademik.uni-pr.edu/>), ndërsa të njëjtat duhet t'i dorëzojnë edhe në formë fizike në njësinë përkatëse akademike ku bëhet verifikimi i dokumenteve dhe konfirmohet aplikimi online.
2. Punimet shkencore të publikuara në revista ndërkombëtare nuk ka nevojë të skanohen në tërësi, por vetëm faqja e parë dhe e fundit e punimit (përfshirë konkluzionet), ndërsa për libra dhe monografi të botuar duhet të skanohet faqja e parë e librit dhe faqja në të cilën shihet katalogimi në botim (CIP).
3. Aplikimi, përmes platformës online dhe ai fizik, fillon **më 2 qershor 2026** dhe zgjat deri më **16 qershor 2026, ora 16:00**.
4. Aplikacionet e arritura pas afatit dhe ato të pakompletuara nuk do të merren në shqyrtim.
5. Pas mbylljes së afatit të konkursit, nuk mund të dorëzohet asnjë dokument shtesë, as në formë të shkruar dhe as elektronike.

